



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 7334 Prot.,

Fier, më 18.06.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 63, datë 18.06.2025

mbi projekt-vendimin

“Për një shtesë pasurie të paluajtshme për shpronësim për interes publik , në kuadër të realizimit të projektit “Rikonstruksioni i Segmentit rrugor ”Shën Gjergji -Naun Kaçaku (ish Ura me shkallë -Stacioni i Patosit)”, vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier , projekt për të cilin është miratuar akti normativ VKM Nr.94 , datë 12/02/2025 .

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë ____/____/2025, i paraqitet për shqyrtim materiali nga ekzekutivi i Bashkisë Fier, për shtimin e një pasurie të paluajtshme, pronë private , pasuri e cila preket pjesërisht , vetëm në pasurinë e llojit truall, nga gjurma e re e projektit , si rrjedhojë e zgjatjen e gjurmës së projektit , sipas gjurmës së re të hartuar nga grupi I punës dhe planvendosja përkatëse . Pasuria e cila preket është pasuri në bashkëpronësi të shtetasve Eu gjen Themi Dëma + katër bashkëpronarë , pasuri në bashkëpronësi e pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie . Nga ana e Bashkisë Fier referuar tabelës (formatit tip) bashkëlidhur projektvendimit janë pasqyruar të dhënat e gjëndjes juridike si dhe është bërë vlerësimi paraprak , në respektim të së drejtës ligjore të pronësisë për bashkëpronarët Dëma si dhe me qëllimin kryesor të realizimit të projektit .

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.2, gërma “b”, si dhe neni 54 , gërma “k” , ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” i ndryshuar dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, si dhe dokumentacioneve teknike administrative dhe ligjore të grupit të punës , ekzekutivi i Bashkisë Fier,

PROPOZON:

1.Të miratojë një shtesë pasurie të paluajtshme për shpronësim për interes publik , në kuadër të realizimit të projektit “Rikonstruksioni i Segmentit rrugor ”Shën Gjergji -Naun Kaçaku (ish Ura me shkallë -Stacioni i Patosit)”, sipas tabelës me të dhënat e pronarëve dhe pasurisë bashkëlidhur

2. Vlerësimi paraprak I shpronësimit për interes publik të përballohet nga buxheti I Bashkisë Fier për vitin 2025;

3. Për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave administrativo-ligjore me Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin pranë MIE Tiranë ,ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Fier.

Drejtoria e Hartimit të Projekteve dhe Infrastrukturës

Haxhi Avdullaj

Drejtoria Juridike

E.Kapllanaj

Dr. E Menaxhimit të Pronave

A.Behari

Dr. Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit

P.Çina

**NË MUNGESË E ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Martin Dodi**

**KRYETAR
Armando Subashi**

